



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2021 regjistri (JD)
Datë. 15.10.2021

Nr. 01 i vendimit
Datë 17.01.2022

VENDIM
PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegjit i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Gjyqtar
Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Sokol Çomo	Gjyqtar

– mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi, më datë 17.01.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 8/2021, datë 15.10.2021, që i përket:

KËRKUES: Hasan Roqi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Anëtarët e Komisionit të Disiplinës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave.

OBJEKTI: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 949/8, datë 31.05.2021, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me magjistratët: D. M.(prokuror në SPAK); S. B. (gjyqtar në Gjykatën e Lartë); S. D.(gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar); Dh. L. (gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) lënë në fuqi, pa vendim njoftimi, nga anëtarët e Komisionit Disiplinor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, lënë në fuqi nga vendimi nr. {***}, datë 15.09.2021, i Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në kuadër të përkrahjes së pandëshkueshmërisë, mungesës së transparencës, ndikimit politik dhe korrupsionit, si vendime në cenim të drejtëpërdrejtë dhe në mënyrën më arbitrare të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, legjislacionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë, Kushtetutës së RSH, ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurës Penale, Kodit Penal, ligjet e veçanta, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,

vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, interesave ligjorë, shëndetësorë, moralë e financiarë të kërkuesit dhe të familjarëve të tij.

2. Vendosja para përgjegjësisë disiplinore, civile, penale, administrative, e subjekteve të interesuara, të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës në KLGj, anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave në KLP, mbrojtës të veprimtarisë së paligjshme antikushtetuese të magjistratëve: D. M. S. B., S. D., Dh. L., duke dhënë masa disiplinore edhe për këta magjistratë. Ndalimi si masë disiplinore për llogari të viktimës kërkuese dhe familjarëve të tij nga tre paga mujore nga pagat e anëtarëve të Komisionit të Disiplinës në KLGj dhe anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të shqyrtimit të Ankesave në KLP.

3. Dhënia e garancisë procedurale nga Komisioni i Posaçëm i Apelimit, në mbrojtje të ekzekutimit të të drejtave që rrjedhin nga vendimi 76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit të veçantë, pikës 9, germa “ç” e udhëzimit të KM nr. 3, datë 21.06.1993, për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit të saj nr.76/2000, regjistrimin në Kadastër të pjesës reale 37% të familjes Roqi, përfshirë 205 m² truall dhe rivendosur në posedim të pronës. Për shkak të zgjatjes së këtij afati të mosekzekutimit të vendimit 76/2000 nga data 08.11.2000, si pjesë e procesit gjyqësor, të paguhet dëmshpërblimi 100 000 lekë për çdo vit vonesë në ekzekutim, nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

4. Shpërblimi i dëmit financiar material dhe moral për 117 muajsh nga dita e nxjerrjes me dhunë kriminale shtetërore nga posedimi i ligjshëm i pronës, në shkelje flagrante të ligjit dhe vendimit 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, nga strukturat plaçkitëse në pushtet e gjykatë, në shumën 70.200 euro për dëmin material dhe 60.000 euro për dëmin moral, 10.000 euro për secilin nga 6 anëtarët e familjes Roqi të plaçkitur e dhunuar nga banda kriminale në pushtet. Rikonstruksioni i banesës së shkatërruar me urdhër të pushtetit, duke e sjellë në parametrat e mëparshëm: në vlerën 4 000 000 (katër milionë) lekë.

5. Publikimi në median publike të pasojave të rënda ripersekutuese, diskriminuese, morale shëndetësore, ekonomike të familjes Roqi, nga banda e strukturuar kriminale në pushtet, administratë, gjykata e SPAK, përkrahur nga Komisioni Disiplinor i Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Komisioni i Përkohshëm i Shqyrtimit të Ankesave në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Publikimi i rivendosjes së të drejtave kushtetuese nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

6. Mbrojtja e jetës së familjarëve të familjes Roqi, H. R., L. R., S. R., K. R., nga banda e strukturuar kriminale.

BAZA LIGJORE:

- Neni 6.1, neni 8, neni 13, neni 14, neni 41 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- Neni 17, pikat 1, 2, neni 18, pikat 1, 2, 3, neni 25, neni 37, pika 1, neni 41, pikat 1, 2, neni 44, neni 131, shkronja “f”, neni 132, pikat 1, 2, neni 134, pika 1, shkronja “i”, neni 139, pika 1, shkronja “d”, neni 140, pika 1, pika 2, shkronja “a”, neni 142, pika 3, neni 145, pikat 1, 2, neni 147/b, pika 1, shkronja “d”, neni 147/c, pika 1, pika 2, shkronja “a”, neni 148/d, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 4, shkronja “c”, neni 148/dh, pika 4, neni 149/c, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c”, neni Dh, pika 3, neni E, pika 3, pika 4, Aneksi i Kushtetutës, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Neni 1, pika 2, neni 3, pika 1, neni 71, pika 1, neni 71/a, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”. Neni 71/ç, pika 1, pika 4, neni 72, pika 7, neni 76, pika 1, neni 81, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.
- Neni 5, pika 3, shkronja “a”, shkronja “b”, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Neni 5, neni 6, pika 1, pika 2, pika 3, pika 4, neni 103, neni 104, pika 2, pika 3, pika 4, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”.
- Neni 100, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “f”, pika 2, shkronja “b”; neni 101, pika 1, shkronjat “a”, “b”, pika 2, shkronjat “ç”, “d”, neni 102, pika 1, shkronja “dh”, pika 4, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, pika 5, neni 111, pika 1, shkronjat “a”, “b”, neni 117, neni 119, pika 1, neni 120, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, pika 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, neni 121, pika 2, shkronjat “b”, “c”, neni 123 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997, i Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese.
- Neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile.
- Pika 9, shkronja “ç”, përfshirë shembullin në fund të kësaj pike, udhëzimi KM nr. 3, datë 21.06.1993, për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.
- Vendimet nr. 76/2000; nr. 33/2005; nr. 26/2005; nr. 11/2007; nr. 6/2006; nr. 43/2007; nr. 1/2009 të Gjykatës Kushtetuese.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtarin relator Ardian Hajdari, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është administruar kërkesa e paraqitur nga z. Hasan Roqi me nr. prot. {***}, datë 04.10.2021, me objekt dhe bazë ligjore si ajo e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
2. Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.10.2021, me lëndë “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”, Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ka kërkuar z. Hasan Roqi plotësimin e kërkesës në përputhje me nenin 27, pika 2, gerrat “a” dhe “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (në vijim ligji nr. 8577, datë 10.02.2000).
3. Në vijim sa më sipër, kërkuesi ka depozituar shkresën nr. {***} prot., datë 15.10.2021, në Kolegji me plotësimet e kërkuara duke dorëzuar tri kopje të kërkesës, adresën e institucionit, kopje të vërtetuar të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2021, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe një kopje të vendimit nr. 76, datë 08.11.2000, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
4. Në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, parashikohet se *kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga Kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori*. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Hasan Roqi, është shortuar pranë këtij Kolegji më datë 20.10.2021, dhe në vijim të nenit 31, është caktuar dhe trupa gjyqësore për shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë.
5. Me shkresën nr. {***}, datë 12.11.2021, kërkuesi i drejtohet Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me objekt “Plotësim kërkesë në çështjen (JD) nr. 8/2021, datë 15.10.2021, që i përket kërkuesit Hasan Roqi”, ku paraqet si qëllim kryesor të kësaj kërkesë faktin se më datë 09.11.2021, ka marrë dijeni për vendimin nr. {***}, datë 27.10.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke dhënë pretendimet ligjore ndaj këtij vendimi.

I. Rrethanat e çështjes

6. Kërkuesi ka paraqitur dy kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, respektivisht në datat 14.04.2020 dhe 16.04.2020, ndaj një sërë individësh, ish-funksionarë dhe funksionarë aktualë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë.
7. Me vendimin nr. {***}, datë 29.04.2020, Prokuroria e Posaçme ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal. Të njoftojë me këtë vendim kallëzuesin Hasan Roqi, i cili ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim të Prokurorisë së Posaçme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila, me vendimin nr. {***}, datë 12.06.2020, ka vendosur: *1. Rrëzimin e kërkesës së ankuesit Hasan Roqi, regjistruar me nr. {***} akti, datë 12.05.2020*. Ndaj ankimit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 16.09.2020, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 12.06.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*.
8. Kërkuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) me ankesat nr. {***} prot., datë 17.08.2020, nr. {***} prot., datë 18.11.2020, nr. {***} prot., datë 17.02.2021, nr. {***} prot., datë 17.02.2021, nr. {***} prot., datë 17.02.2021, në përmbajtje të cilave ngre pretendime ndaj veprimtarisë hetimore të prokurores së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim “SPAK”), znj. D. M., veprimtarisë gjyqësore të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, z. F. P., dhe veprimtarisë

gjqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. S. D., z. Dh. L., z. S. B. (aktualisht me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Lartë).

9. Me shkresën nr. {***}, datë 31.05.2021, ILD i ka njoftuar kërkuesit Hasan Roqi, vendimin nr. {***} prot., datë 31.05.2021, vendim i cili është marrë bazuar në nenin 121/2, shkronja “a” e ligjit nr. 86/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 115/2016”) dhe ka vendosur: *1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të ankuesit, z. Hasan Roqi. 2. Ky vendim t’i njoftohet ankuesit dhe magjistratëve, znj. S. D., z. Dh. L., z. S. B., znj. D. M. 3. Kundër të këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 1 (një) jave nga marrja e këtij vendimi.*
10. Kërkuesi, më datë 07.06.2021, i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”) me objekt ankimin ndaj vendimit nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe vendosjen e masave disiplinore për shkelje të rënda ndaj magjistratëve, znj. S. D., z. Dh. L., z. S. B. (duke ia kërkuar KLGj-së) dhe për znj. D. M.(kërkesë KLP-së).
11. Komisioni i Përkohshëm i Shqyrtimit të Ankesave pranë KLP-së, pasi u njoh me praktikën e ankesës së z. Hasan Roqi dhe me vendimin nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të ILD-së, ka vendosur me vendimin nr. {***}, datë 15.09.2021: *1. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Relacioni i Komisionit është pjesë përbërëse e vendimit. 3. Të njoftohet për këtë vendim shtetasi Hasan Roqi dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. 4. Ky vendim është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej para mbledhjes plenare të Këshillit.*
12. Komisioni i Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari pranë KLGj-së, me vendimin nr. {***}, datë 27.10.2021, ka vendosur: *Refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesi Hasan Roqi kundër vendimit nr. {***} prot., datë 31.03.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet ankuesit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe gjyqtarëve S. B., S. D., Dh. L.. 3. Ky vendim është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.*

II. Pretendimet e kërkuesit

13. Në kërkesën drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit datë 15.10.2021, kërkuesi Hasan Roqi pretendon se veprimet e paligjshme të magjistratëve të miratuara e të mbështetura nga Kryeinspektori i ILD-së, lënë në fuqi fillimisht nga Komisioni i Disiplinës pranë KLGj-së, si dhe vendimi nr. {***}, datë 15.09.2021, i Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave pranë KLP-së, bien në kundërshtim me nenet 6, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.
14. Veprimet e paligjshme të magjistratëve, sipas kërkuesit, të mbrojtura dhe lënë në fuqi e miratuar nga Kryeinspektori i ILD-së, lënë në fuqi nga Komisioni i Disiplinës pranë KLGj-së, si dhe vendimi nr. {***}, datë 15.09.2021, i Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave pranë KLP-së, janë në shkelje të nenit 17, pikat 1, 2; neni 18, pikat 1, 2, 3; neni 25; neni 37, pika 1; neni 41, pikat 1, 2; neni 44; neni 131, shkronja “f”; neni 132, pikat 1, 2; neni 134, pika 1, shkronja “i”; neni 139, pika 1, shkronja “d”; neni 140, pika 1, pika 2, shkronja “a”; neni 142, pika 3; neni 145, pikat 1, 2; neni 147/b, pika 1, shkronja “d”; neni 147/c, pika 1, pika 2, shkronja “a”; neni 148/d, pika 1, pika 2 shkronja “a”, pika 4,

- shkronja “c”; neni 148/dh, pika 4; neni 149/c, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c”; neni Dh, pika 3, neni E pika 3, pika 4, Aneksi i Kushtetutës, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Këto veprime të kryera me dashje janë të ndëshkueshme nga neni 101, pika 1, shkronjat “a”, “b”, pika 2, shkronjat “ç”, “d”, neni 102, pika 1, shkronja “dh”, pika 4, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, pika 5, neni 111, pika 1, shkronjat “a”, “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
15. Kërkuesi pretendon se shkeljet disiplinore të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës pranë KLGj-së janë në juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në bazë të nenit 5, pika 3, shkronjat “a”, “b”, ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kërkuesi pretendon se anëtarët e Komisionit të Disiplinës pranë KLGj-së dhe anëtarët e Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave pranë KLP-së e kanë për herë të dytë që nxjerrin vendimmarrje në shkelje të Kushtetutës, prandaj, sipas tij, duhet të përgjigjen me një kompensim minimal 6 muaj nga paga e tyre kërkuesit, dhe të përjashtohen nga funksioni që mbajnë.
 16. Kërkuesi kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2021, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me magjistratët: D. M.(prokuror në SPAK); S. B. (gjyqtar në Gjykatën e Lartë); S. D.(gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar); Dh. L. (gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) në kuadër të përkrahjes së pandëshkueshmërisë, mungesës së transparencës, ndikimit politik dhe korrupsionit, si vendime, në cenim të drejtëpërdrejtë dhe në mënyrën më arbitrare të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.
 17. Kërkuesi kërkon vendosjen para përgjegjësisë disiplinore, civile, penale, administrative, të subjekteve të interesuara, të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës në KLGj, anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave në KLP, mbrojtës të veprimtarisë së paligjshme antikushtetuese të magjistratëve: D. M. S. B., S. D., Dh. L., duke dhënë masa disiplinore edhe për këta magjistratë. Ndalimi si masë disiplinore për llogari të viktimës kërkuese dhe familjarëve të tij nga tre paga mujore nga pagat e anëtarëve të Komisionit të Disiplinës në KLGj dhe anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave në KLP.
 18. Kërkuesi kërkon dhënien e garancisë procedurale nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në mbrojtje të ekzekutimit të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit të veçantë, pikës 9, germa “ç” e udhëzimit të KM nr. 3, datë 21.06.1993, për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit të saj nr. 76/2000, regjistrimin në Kadastër të pjesës reale 37% të familjes Roqi, përfshirë 205 m² truall dhe rivendosur në posedim të pronës. Për shkak të zgjatjes së këtij afati, të mosekzekutimit të vendimit nr. 76/2000 nga data 08.11.2000, si pjesë e procesit gjyqësor, të paguhet dëmshpërblimi 100 000 lekë për çdo vit vonesë në ekzekutim, nga ana e Gjykatës Kushtetuese.
 19. Kërkuesi kërkon shpërblimin e dëmit financiar material dhe moral për 117 muaj nga dita e nxjerrjes me dhunë kriminale shtetërore nga posedimi i ligjshëm i pronës, në shkelje flagrante të ligjit dhe vendimit nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, nga strukturat plaçkitëse në pushtet e gjykatë, në shumën 70.200 euro për demin material dhe 60.000 euro për dëmin moral, 10.000 euro për secilin nga 6 anëtarët e familjes Roqi të plaçkitur e dhunuar nga banda kriminale në pushtet. Rikonstruksioni i banesës së shkatërruar me urdhër të pushtetit, duke e sjellë në parametrat e mëparshëm: në vlerën 4 000 000 (katër milionë) lekë.
 20. Kërkuesi kërkon publikimin në media të pasojave të rënda ripërsekutuese, diskriminuese, morale shëndetësore, ekonomike të familjes Roqi, nga banda e strukturuar kriminale në pushtet, administratë, gjykata e SPAK, përkrahur nga Komisioni Disiplinor i KLGj-së, si dhe Komisioni i Përkohshëm i

Shqyrtimit të Ankesave në KLP. Publikimi i rivendosjes së të drejtave kushtetuese nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

21. Kërkuesi kërkon mbrojtjen e jetës së familjarëve të familjes Roqi, H. R., L. R., S. R., K. R., nga banda e strukturuar kriminale.
22. Në kërkesën e datës 12.11.2021, me objekt “Plotësim kërkesë”, ankuesi pretendon se vendimi nr. {***}, datë 27.10.2021, i Komisionit Disiplinor të Komisionit të Përkohshëm të KLGj-së, është marrë në tejkalim të afatit 3-mujor të parashikuar nga ligji, si dhe ka konstatuar shkelje në dukje të formimit dhe legjitimitetit të këtij komisioni, pasi vendimi është dhënë nga anëtarë që nuk janë kompetentë dhe nuk kanë juridiksion disiplinor.
23. Në përfundim të kësaj kërkesë (shitesë), ankuesi ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm të Apelit të pranojë objektin me 6 kërkesa të tij, të paraqitura më datë 01.10.2021.

III. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

24. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit do të veprojë si një nga dy kolegjet e Gjykatës Kushtetuese, në këtë mënyrë dhe veprimtaria e tij në kuadër të Juridiksionit Disiplinor do të shtrihet nën kornizën ligjore të kësaj gjykate. Për rrjedhojë, procedura për vlerësimin e kërkesës së kërkuarit dhe shqyrtimi i saj do të bëhet bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
25. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak (në vijim “Kolegji”) sjell në vëmendje se dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në kuadër të juridiksionit disiplinor, konkretisht neni 179, pika 7 e Kushtetutës, ku parashikohet: *[...] Gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...], si dhe neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: *[...] 3. Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.**

Mbi pretendimet e kërkuarit

Lidhur me kërkimin e parë të objektit të kërkesës së numërtuar me nr. “1”, tek objekti i këtij vendimi, ku kërkohet nga kërkuesi konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2021, të ILD-së, Kolegji fillimisht vlerëson të analizojë llojin e këtij vendimi të ILD-së objekt shqyrtimi dhe natyrën e tij, duke u ndalur në veçanti në juridiksionin e Kolegjit për shqyrtimin e këtyre llojeve vendimesh, konkretisht:

26. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak konstaton se ILD-ja, pas verifikimit të ankesës së kërkuesit ndaj disa magjistratëve, ka marrë vendimin nr. {***}, datë 31.05.2021, pasi sipas nenit 147/d, pika 1 e Kushtetutës, ILD-ja është organi përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGj-së, anëtarëve të KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj, ky vendim është bazuar në nenin 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹, si dhe në nenin 121 të këtij ligji.
27. Kolegji vëren se në zbatim të neneve 62 dhe 160, pika 13 e ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”², i ndryshuar, rezulton se vetëm komisionet përkatëse, respektivisht pranë KLGj-së dhe KLP-së, kanë kompetencën për shqyrtimin e vendimeve të ILD-së në rastet kur kjo e fundit ka vendosur për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari apo prokurori.
28. Referuar nenit 179, pika 7 e Kushtetutës³, si dhe nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁴, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka në juridiksionin e tij vetëm shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të KLGj-së, KLP-së dhe ILD-së, për të cilat është dhënë masa disiplinore përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. Me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2021, të ILD-së, nuk rezulton të jetë dhënë masë disiplinore ndaj magjistratëve, por është një vendim për arkivimin e ankesës ku neni 121, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka përcaktuar qartë organin ku mund të ankimohen këto vendime, konkretisht: *“Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar”*.
29. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se kërkuesi e ka ankimuar vendimin nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të ILD-së pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave pranë KLP-së, i

¹ *“Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme: d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur; dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji”*.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme. 2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos: a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriteret të parashikuara në pikën 1, të nenit 120, të këtij ligji. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

² *“Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit”*.

³ *“Gjyqtarët e Kolegjit të Apelit kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”*.

⁴ *Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislationit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: “a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”*.

cili me vendimin nr. {***}, datë 15.09.2021, ka vendosur: *1. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {***} prot., datë 31.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, po kështu dhe Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari pranë KLGj-së, me vendimin nr. {***}, datë 27.10.2021, ka vendosur: Refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesi Hasan Roqi kundër vendimit nr. {***} prot., datë 31.03.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

30. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, Kolegji vlerëson se kërkesa drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2021, të ILD-së, nuk hyn në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese dhe, për pasojë, ky kërkim është i pabazuar në ligj pasi nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 31/a, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Lidhur me kërkimin e dytë të objektit të kërkesës të numërtuar me nr. “2” tek objekti i këtij vendimi, ku kërkesi Hasan Roqi pretendon vendosjen para përgjegjësisë disiplinore, civile, penale, administrative, të subjekteve të interesuara, të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës në KLGj, anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave në KLP, mbrojtës të veprimtarisë së paligjshme antikushtetuese të magjistratëve: D. M., S. B., S. D., Dh. L., duke dhënë masa disiplinore edhe për këta magjistratë, pasi shkeljet disiplinore të anëtarëve të Komisionit të Disiplinës pranë KLGj-së janë në juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në bazë të nenit 5, pika 3, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji fillimisht vlerëson të analizojë legjitimitetin e kërkesit dhe bazueshmërinë *prima facie* të kërimit në lidhje me këtë objekt shqyrtimi, duke u bazuar në veçanti në juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit për shqyrtimin e këtyre kërtimeve, konkretisht:

31. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak fillimisht vlerëson se kërkimet për shqyrtimin e kërkesave për procedime penale, administrative apo civile ndaj magjistratëve, janë tërësisht përtej juridiksionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi pika 7 e nenit 179 të Kushtetutës dhe neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në shqyrtimin e shkeljeve disiplinore.
32. Kolegji, për të identifikuar këtë pretendim të kërkesit, analizoi dispozitat ligjore që i referohen organit përgjegjës dhe kompetencës që ai ka në rastet e përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të KLGj-së, si dhe anëtarëve të KLP-së. Në nenin 6 dhe 104, “Procedura disiplinore”⁵, të ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, janë parashikuar organet që hetojnë dhe shqyrtojnë shkeljet disiplinore, si dhe vendimet që ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu, një

⁵ 1. *Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

2. *Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.* 3. *Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastet e parashikuara në Kushtetutë.* 4. *Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

1. *Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.* 3. *Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rastet e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.* 4. *Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

përcaktim më i detajuar mbi organin kompetent që ka juridiksionin në hetimin e shkeljeve disiplinore të anëtarëve të KLGj-së dhe KLP-së, parashikohet në nenin 194, pikat 1, 2 të ligjit nr. 115/2016⁶.

33. Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar në mënyrë të qartë sferën e juridiksionit disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, llojet e vendimeve që merren në shqyrtim nga ky Kolegj në kuadër të juridiksionit disiplinor, subjektet dhe institucionet përgjegjëse që kanë tagrin për të marrë në shqyrtim apo ankimuar vendimet përkatëse, si dhe procedurën që ndiqet në trajtimin e rasteve me karakter disiplinor, konkretisht në nenin 6, pika 4 dhe nenin 104, pika 4 e ligjit nr. 115/2016, është parashikuar se Gjykata Kushtetuese (Kolegji i Posaçëm i Apelit) zhvillon procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të KLGj-së dhe KLP-së, kurse inicimi, verifikimi dhe hetimi i shkeljes ndaj këtyre anëtarëve kryhet nga ILD-ja sipas procedurës së parashikuar në nenin 194 të po këtij ligji.
34. Nga analiza në tërësi e pretendimeve të kërkuesit, megjithëse në pamje të parë këto kërkesa duket sikur përmbajnë elemente të procesit disiplinor ndaj magjistratëve, rezulton se kërkimet e tij, përveçse nuk shtrihen ndaj vendimeve të ILD-së, për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të KLGj-së apo KLP-së, ato nuk referojnë në asnjë nga rastet e parashikuara në nenet 5, 5/1, 5/2, 5/3, 6, nenet 103, 103/1, 103/2, 103/3 dhe 104 të ligjit nr. 115/2016, apo nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, për vendosjen para përgjegjësisë disiplinore të personave që citohen në kërkesë. Për pasojë, Kolegji e gjen këtë kërkesë të pabazuar në fakte dhe në ligj.
35. Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, Kolegji arrin në konkluzionin se autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj anëtarëve të KLGj-së dhe anëtarëve të KLP-së është ILD-ja, e cila kryen hetimin ndaj këtyre subjekteve, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe vlerëson se kjo kërkesë nuk kalon testin e parashikuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “b” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet: *kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet.*
36. Kolegji, në kuadër të vlerësimit të kriterëve për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, mori në shqyrtim edhe kërkesat e kërkuesit të numërtuar me numrat respektivë tek objekti i këtij vendimi, si më poshtë:
 - 3) dhënien e garancisë procedurale të ekzekutimit të të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese;
 - 4) shpërblimin e dëmit financiar material dhe moral në masën e caktuar nga ai;
 - 5) rikonstruksionin e banesës së shkatërruar duke e sjellë në parametrat e mëparshëm;
 - 6) publikimin në median *online* të pasojave të rënda ripërsekutuese, diskriminuese, morale shëndetësore, ekonomike të familjes Roqi, si dhe mbrojtjen e jetës së familjarëve të familjes Roqi nga banda e strukturuar kriminale.
37. Për pasojë, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak vlerëson se këto kërkesa të sipërcituara në paragrafin nr. 36, nuk i takojnë sferës së çështjeve që përfshihen në juridiksionin disiplinor, në kuptim të nenit 31/a, pika 2,

⁶ “*Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë; [...Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në: a) ankimin me shkrim të çdo personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar [...].*”

germa “a” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, dhe çmon se gjykimi disiplinor lidhur me këto pretendime, nuk mund të vihet në lëvizje.

38. Në analizë të dispozitave të mësipërme, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuarit janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe nuk mund të merren në shqyrtim nga ky Kolegj.

Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji, bazuar në parashikimet e nenit 31, pika 3 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, dhe në zbatim të dispozitave të nenit 31/a, pika 2, gjerat “a” dhe “b” të po këtij ligji, çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 17.01.2022.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi